

URDHËR
Nr. 5, datë 20.1.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Integrimit European, zëvendës-ministrit të Ministrisë së Integrimit European, znj. Eralda Çani, për shkak të mungesës për arsye pune jashtë Republikës së Shqipërisë të titullarit të Ministrisë së Integrimit European.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Integrimit European do të ushtrohen për periudhën nga data 23.1.2017 deri në datën 24.6.2017.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Integrimit European, znj. Eralda Çani.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INTEGRIMIT EUROPIAN
Klajda Gjasha